

URDHËR
Nr. 473/1, datë 1.10.2024

**PËR NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 473, DATË 4.9.2024, “PËR DELEGIM
KOMPETENCE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe pikës 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 473, datë 4.9.2024, “Për delegim kompetence”, pika 1, pas shkronjës “h”, të shtohet shkronja “i”, me përmbajtje si më poshtë vijon:

i) të nënshkruajë urdhrin për dërgimin me shërbim jashtë vendit, të punonjësve të institucioneve të varësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE**
Albana Koçiu